| **SHARE TRANSFER DEED** | **MARRËVESHJE TRANSFERIMI KUOTASH** |
| --- | --- |
| *Today, on this day 27.12.2018, the following parties entered into this Share Transfer Deed ("**Agreement**"):* | *Sot më 27.12.2018, palët e mëposhtme lidhën këtë Marrëveshje Transferimi Kuotash ("**Marrëveshja**"):* |
| **(1)** **Mr. Klodian Zyberi,** Albanian citizen, born in Lezha, on 18.07.1979, holder of the Passport no. BF2920870, resident at "Peti" street, "Beta" building, entrance no. 2, ap. 1, Tirana, Albania (the "**Seller**"); and | **(1)** **Z. Klodian Zyberi,** shtetas shqiptar, lindur në Lezhë, më 18.07.1979, mbajtës i Pasaportës me nr. BF2920870, banues në Rrugën "Peti", pallati "Beta", shkalla 2, ap. 1, Tiranë, Shqipëri ("**Shitësi**"); dhe |
| **(2)** **PRIMUS ADRIATIC d.o.o. za usluge,** a limited liability company, organized and existing under the laws of Croatia, having its registered office at Stube Ivana Kozarca 3, Zagreb, Croatia, duly represented by Mr. Hrvoje Čabrajić, a Croatian citizen, born in Sarajevo, Bosnia and Herzegovina, on 25.01.1968, holder of ID no. 26730105608, residing at Zagreb, Croatia (the "**Buyer**"). | **(2)** **PRIMUS ADRIATIC d.o.o. za usluge** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas legjislacionit të Kroacisë, me seli të regjistruar në Stube Ivana Kozarca 3, Zagreb, Kroaci, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Hrvoje Čabrajić, shtetas kroat, lindur në Sarajevë, Bosnie dhe Hercegovinë më 25.01.1968, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 26730105608, rezident në Zagreb, Kroaci ("**Bleresi**"). |
| Each of the Seller and the Buyer is hereinafter referred to as a "**Party**" and, jointly, as the "**Parties**". | Shitësi dhe Blerësi në vijim do të referohen veçmas si "**Palë**" dhe bashkarisht si "**Palët**". |
| **WHEREAS:** | **MEQËNËSE:** |
| • Seller is the shareholder of the company JEHONA SOFTWARE sh.p.k.., a limited liability company organized and existing under the laws of the Republic of Albania, registered under Law no. 9901, dated 14.04.2008, registered with the Albanian Commercial Register with the National Business Center (NBC), with business no. *(NIPT):* **L42202028V,**with legal seat at the address: Nj.B. no 5, Rr. Prokop Mima, P. Universal, H.1, K.1A, Tirana, Albania (the "**Company**"). | • Shitësi është ortak i shoqërisë JEHONA SOFTWARE Shpk., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008, pranë Regjistrit Tregtar të Shqipërisë në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me numër unik identifikimi të subjektit *(NIPT):* **L42202028V,** me seli të regjistruar në adresën: Nj.B. no 5, Rr. Prokop Mima, P. Universal, H.1, K.1A, Tiranë, Shqipëri ("**Shoqëria**"). |
| • The Seller and the Buyer entered into a share purchase agreement dated 06.09.2018 ("**SPA**"). On and subject to the terms of the SPA, the Seller has agreed to sell and the Buyer has agreed to buy all the shares owned by the Seller in the capital of the Company, representing 100% of the share capital of the Company (the "**Shares**"). | • Shitësi dhe Blerësi kanë lidhur një kontratë për blerjen e kuotave, datë 06.09.2018 ("**KBK**"). Sipas dhe në përputhje me kushtet e KBK, Shitësi ka pranuar të shesë dhe Blerësi ka pranuar të blejë te gjitha kuotat e zotëruara nga Shitesi ne kapitalin e Shoqërisë, që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë ("**Kuotat**"). |

| | |
|---|---|
| • In complying with their obligations arising pursuant to the SPA the Parties have agreed to sign this Agreement in order to transfer the ownership of the Shares from the Seller to the Buyer and register the Buyer as the sole legal owner of all the Shares of the Company with any and all competent authorities in the Republic of Albania. | • Në përmbushje të detyrimeve të tyre sipas KBK, Palët pranojnë të nënshkruajnë këtë Marrëveshje për transferimin e pronësisë mbi Kuotat nga Shitësi tek Bleresi dhe regjistrimin e Bleresit si pronari i vetëm dhe i ligjshëm i të gjithë Kuotave të Shoqërisë pranë çdo dhe të gjithë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë. |
| **NOW THEREFORE**, and in consideration of the foregoing premises, the Parties agree as follows: | **PËR KËTO ARSYE,** në bazë të kushteve paraprake të mësipërme, Palët pranojnë sa vijon: |
| **1.** On the signing date of this Agreement, the Seller transfers the Seller's Share to the Buyer and the Buyer acquires and agrees to accept the Seller's Share from the Seller, thus acquiring full ownership right of the Seller's Share on the terms of the SPA and this Agreement. | **1.** Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Shitësi transferon Kuotat e Shitësit tek Bleresi dhe Bleresi blen dhe pranon Kuotat e Shitësit nga Shitësi, dhe si rrjedhojë fiton titull të plotë pronësie mbi Kuotat e Shitësit sipas kushteve të KBK dhe të kësaj Marrëveshjeje. |
| **2.** The Parties acknowledge and agree that the SPA shall survive the execution and performance of this Deed, and that except where this Agreement expressly provides otherwise, this Agreement shall not vary, waive or modify in any respect the terms of the SPA and the execution of this Agreement shall be without prejudice to the rights or obligations of the Parties under the SPA. | **2.** Palët njohin dhe pranojnë se KBK do të vazhdojë të mbetet në fuqi edhe pas ekzekutimit dhe nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç rastit kur në këtë Marrëveshje parashikohet ndryshe kjo Marrëveshje nuk ndryshon, nuk përbën heqje dorë nga apo nuk modifikon në asnjë mënyrë kushtet e KBK dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje nuk do të paragjykojë të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas KBK. |
| **3.** The Seller agrees that the Buyer shall submit this Agreement to be registered with the Trade Registry of the Albanian National Business Center, immediately following the signing of this Agreement. | **3.** Shitësi pranon që Bleresi të depozitojë këtë Marrëveshje pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje. |
| **4.** The Seller undertakes to take all necessary actions to assist the Buyer to register its ownership over the Shares. | **4.** Shitësi pranon se do të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme për të asistuar Bleresin në regjistrimin e titullit të tij të pronësisë mbi Kuotat. |
| **5.** Each Party to this Agreement represents and warrants to other Party that such Party has read and fully understands the terms and provisions hereof, that is has had an opportunity to review this Agreement with its legal counsel, and has executed this Agreement based upon such Party's own judgment and advice of its legal counsel. | **5.** Secila nga Palët e kësaj Marrëveshjeje i deklaron dhe i garanton Palës tjetër se i ka lexuar dhe i ka kuptuar plotësisht kushtet dhe parashikimet e kësaj marrëveshjeje, se e ka rishikuar këtë Marrëveshje me këshilltarin e saj ligjor dhe se e ka nënshkruar këtë Marrëveshje bazuar në gjykimin të kësaj Pale vetë dhe të këshilltarit të saj ligjor. |
| This Agreement is prepared in Albanian and English | Kjo Marrëveshje është hartuar në Shqip dhe në |

| | |
|---|---|
| languages in 5 (five) identical counterparts of each language version. In case of discrepancy between the Albanian and English languages versions, the English version shall prevail.<br><br>*The agreement was read and signed by the parties, today on 27 December 2018.* | Anglisht në 5 (pesë) kopje identike në secilën prej gjuhëve. Në rast mospërputhjeje ndërmjet versionit në gjuhën Shqip dhe atij në Anglisht, përparësi ka ai në gjuhën Angleze.<br><br>*Kjo marrëveshje u lexua dhe u nënshkrua nga Palët sot më 27 Dhjetor 2018.* |

**Seller / Shitësi:**

**Klodian Zyberi**

Klodian Zyberi

**Buyer / Blerësi:**

**PRIMUS ADRIATIC d.o.o. za usluge**

**Hrvoje Čabrajić**

HRVOJE ČABRAJIĆ

PRIMUS ADRIATIC d.o.o.
ZAGREB